



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

Nr./Br. 30117 34117
Datë/Datum, 10.03.2017

PRIŠTINË - PRIŠTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 30/17
34/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z.Nuhi Paçarizi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesave së parashtruara nga OE ankues “N.T.P VLORA” – Prishtinë dhe OE “INFINIT Sh.p.k” – Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material harxhues-administrativ për SHCK-në, Shkollat, Zjarrfikësit dhe Shëndetësinë”, me nr prok:“652/16/109/121”, të iniciuar nga autoriteti kontraktues /Komuna e Kaçanikut/, më datën 06.03.2017 mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohen**, pjesërisht si të bazuara ankesat e OE “N.T.P VLORA” – Prishtinë dhe “INFINIT Sh.p.k” – Prishtinë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material harxhues-administrativ për SHCK-në, Shkollat, Zjarrfikësit dhe Shëndetësinë”, me nr prok:“652/16/109/121”, iniciuar nga autoriteti kontraktues /Komuna e Kaçanikut/.
- II. **Anulohet**, vendimi i AK-së /Komuna e Kaçanikut/, për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit veror dhe dimërор në Komunën e Kaçanikut”, me nr prok:”652/16/112/221”.dhe lënda kthehet në Rivlerësim.
- III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

- IV. Operatorit ekonomik ankues OE “N.T.P VLORA” – Prishtinë dhe OE “INFINIT Sh.p.k” – Prishtinë, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa i është aprovuar si e bazuar.
- V. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

- Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:14.12.2016.
- Hapja e ofertave është bërë me dt:04.01.2017, ku kanë marr pjesë shtatë (7) operatorë ekonomik.
- Letra Standarde për operatorin ekonomik të pa suksesshëm “NTP VLORA”-Ferizaj, është dërguar me datën 11 janar 2017.
- Letra Standarde për operatorin ekonomik të pa suksesshëm “INFINIT Sh.p.k”-Prishtinë, është dërguar me datën 17 janar 2017.
- Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me dt:17.01.2017, e ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “NTSH Rilindja Comerc”- Ferizaj.
- Kundër njoftimit për dhënie të kontratës, operatori ekonomik “NTP VLORA” - Ferizaj me dt:23.01.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.
- Kundër njoftimit për dhënie të kontratës, operatori ekonomik “INFINIT Sh.p.k”- Prishtinë me dt:23.01.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.
- Me dt:24.01.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “NTP VLORA”-Ferizaj.
- Me dt:25.01.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “INFINIT Sh.p.k”-Prishtinë.

Operatori ekonomik “N.T.P VLORA” – Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më 23 janar 2017 me nr. 30/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës me titull “Furnizim me material harxhues-administrativ për SHCK-në, Shkollat, Zjarrfikësit dhe Shëndetësinë”, me nr prok:“652/16/109/121”, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 7 i LPP së –Barazia në trajtim/Jo diskriminim
- Neni 10 i LPP së–mjetet per promovimin e transparencës
- Neni 59 i LPP-së–Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 61 i LPP-së –Tender jo normalisht të ulet
- Neni 65 i LPP-së– Pranueshmëria e kandidatëve ose tenderuesve
- Neni 66 i LPP-së –Përshtatshmëria profesionale
- Neni 69 i LPP-së–Aftësitë teknike dhe profesionale

Operatori ekonomik “INFINIT Sh.p.k” – Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më 02 shkurt 2017 me nr. 34/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës me titull: “Furnizim me material harxhues-administrativ për SHCK-në, Shkollat, Zjarrfikësit dhe Shëndetësinë”, me nr prok:“652/16/109/121”, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 1 i LPP-së –Qëllimi i Ligjit
- Neni 51 i LPP-së-Njoftimi i kritereve të përzgjedhjes
- Neni 59 i LPP-së- Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 61 i LPP-së- Tender jo normalisht të ulet
- Neni 72 i LPP-së-Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
-

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese përmes raportit të datës 20 shkurt 2017, ka menduar që AK për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material harxhues-administrativ për SHCK-në, Shkollat, Zjarrfikësit dhe Shëndetësinë”, me nr prok:“652/16/109/121”, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së. Prandaj ekspertja shqyrtues i ka propozuar panelit shqyrtues qe të anuloj vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në RIVLERËSIM, ndërsa ankesat e OE-ve ankues të aprovohen si pjesërisht të bazuara.

Operatori ekonomik ankues “N.T.P VLORA” – Prishtinë, me datë: 22 shkurt 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertes shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues “INFINIT Sh.p.k” – Prishtinë, me datë: 24 shkurt 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertes shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues me datë: 24 shkurt 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 06.03.2017, e cila është mbajtur pa praninë e palëve në procedurë, konform nenit 28.1 të rregullores së Punës së OSHP-së, kanë qenë prezent kryetari i panelit shqyrtues, ekspertja shqyrtuese, ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për konratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertja shqyrtuese ka deklaruar: “Sa i përket OE ”Vlora”, në ankesë ka sulmuar disa OE në vazhdimësi, lidhur me pretendimin e OE ankues lidhur me ofertën e OE Rilindja, sqaroj se pretendimet lidhur me formularin C të tenderit është i paqëndrueshëm sepse OE Rilindja ka precizuar të dhënat e nevojshme dhe pretendimet se ka ofruar 90 validitet dhe AK ka kërkuar vetëm 60 nuk përbën shkelje. Po ashtu sa i përket pretendimit se OE Rilindja nuk ka shënuar emrin e kompanisë në deklaratë nën betim është i paqëndrueshëm, sepse OE në deklaratë ka ofruar ë gjitha të dhënat. I sqaroj panelit shqyrtues se sa i përket OE Infinit është eliminuar se nuk ka ofruar certifikatën e TVSH-së. Po ashtu për këtë OE në ofertë origjinale nuk gjendet certifikata e TVSH-së, andaj vlerësoj se AK gjatë vlerësimit është dashtë të respektoj nenin 72 par.1, 2 dhe 3 të LPP, për të kërkuar sqarime shtesë, gjithashtu në nenin 39.8 të UOPP-së. Nëse mungon deklarata e TVSH-së mund të kërkohen sqarime, dhe ky pretendim i OE ankues Infinitiv është i qëndrueshëm andaj edh vlerësoj se ankesa është e bazuar dhe duhet obliguar AK-në të veroj konform nenit 72 të LPP-së. Mbi bazën e të cekurave më lartë i rekomandoj panelit shqyrtues që të aprovoj si pjesërisht të bazuara ankesat e OE-ve duke kthyer lëndën në Rivlerësim.

Lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues “Infinit” për mungesë të certifikatës së TVSH-së, paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha dëshmitë relevante, raportin e ekspertes shqyrtuese dhe në të gjitha faktet tjera, sqaron se në ofertën origjinale të këtij OE nuk gjendet certifikata e TVSH-së, mirëpo AK-ja, gjate ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave është dashur të respektoj nenin 72 paragrafi 1, 2, 3 të LPP-së, për të kërkuar sqarime shtesë. Prandaj në lidhje me këtë çështje, paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që të veprojë në harmoni me nenin 72 të LPP-së në lidhje me këto dokumente.

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues “Vlora” përkitazi me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë “Rilindja”, se nuk i ka plotësuar të dhënat e nevojshme në formularin C te dosjes së tenderit dhe se pretendimi se ka ofruar 90 dite validitet, përderisa AK-ja, ka kërkuar vetëm 60 ditë, paneli shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të dhënat e nevojshme në formularin C dhe sqaron se ofrimi i validitetit prej 90 ditësh (në vend të 60 ditëve) nuk përbën ndonjë parregullsi. Prandaj këto pretendime janë të paqëndrueshme. Po ashtu edhe pretendimi tjetër se OE “Rilindja” nuk e ka shënuar emrin e kompanisë në deklaratën nën betim, është i paqëndrueshëm sepse OE në deklaratën e tij i ka ofruar të gjitha të dhënat.

Ndërsa sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues “Vlora”, se OE i rekomanduar për kontratë “Rilindja”, ka ofruar çmime manipulative, paneli shqyrtues sqaron se sipas nenit 61 të LPP-së, është e çështje e AK-së, vlerësimi i çmimeve jo-normalisht të ulëta, prandaj obligohet autoriteti kontraktues të bëjë vlerësimin e çmimeve konform nenit 61 të LPP-së dhe konform Rregullave për Tenderët Jo-normalisht të ulët, për të gjithë operatorët ekonomik që ka nevojë.

Paneli shqyrtues në lidhje me pretendimin e OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë “Rilindja” nuk i ka të bashkangjitura vërtetimin e ATK-së në dosje dhe vërtetimin nga organi komunal se nuk ka bortxhe, konstaton se është i qëndrueshëm ky pretendim dhe konstaton se AK-ja është dashur ti kërkojë këto dokumente para publikimit të njostimit për dhënie të kontratës konform dispozitave të LPP-së.

Paneli shqyrtues, sqaron se OE “Vlora”, në ankesë ka pretendime ankimore edhe për ofertën e OE “Promix”, ku ka theksuar se nuk e ka plotësuar formularin C të dosjes se tenderit, dhe se nuk e ka plotësuar sigurinë e ekzekutimit, numrin e prokurimit, mirëpo këto pretendime duke pasur parasysh dëshmitë dhe faktet e prezantuara, konsiderohen si të pabazuara, pasi që formulari i tenderit i ka të gjitha të dhënat e nevojshme, ndërsa sigurimi i ekzekutimit nuk kërkohet të bëhet me rastin e ofertimit por kërkohet të bëhet para nënshkrimit të kontratës. Prandaj këto pretendime janë të paqëndrueshme. Kurse sa i përket pretendimit të OE ankues se lista e kontratave e OE “Promix” nuk i përmban të dhënat e nevojshme, paneli shqyrtues sqaron se ky OE e ka dorëzuar listën e kontratave, kontratat dhe referencat, prandaj ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e OE ankues Vlora se oferta e OE “Stargraf” dhe “Promix”, janë të njëjtë sepse e kanë numrin e sigurimit të ofertës 75180 përkatësisht 75181 dhe se janë të plotësuara nga një dorë, paneli shqyrtues, sqaron se OE ankues nëse ka dëshmi për këto pretendime atëherë duhet ti drejtohet organeve kompetente konform nenit 131 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – “Komuna e Kaçanikut”
- 1x1 OE – “N.T.P VLORA” – Prishtinë
- 1x1 OE – “INFINIT Sh.p.k” – Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së
- 1x1 Për publikim në web-faqe të OSHP-së.